

Vllaznia humbet perseri

nga Albaniassocer

E shtunë, 31 Janar 2015 18:41



Teuta-Vllaznia 2-1

Ekipi dursak e filloi ndeshjen me vrull ne kerkim te golit te avantazhit.Nga ky presion erdhi traversa e goditur nga Cota ne minuten e peste.Pak nga pak duket se edhe Vllaznia zgjohet por pa arritur te rrezikojne porten durrsake.U duk sikur pjesa e pare do mbyllej pa gola por nje veprim i bukur i Nikes ne krahun e majte ndalet nga Gocaj me nje faull ne zonen shkodrane sipas arbitrit i cili akordon penallti per vendasit.Protestat ishin te shumta nga ana e shkodraneve por arbitri nuk nderron mendje.Nika merr per siper realizimin dhe kalon ne avantazh ekipin e vet.Pjesa e pare mbyllet me durrsaket ne avantazh te nje golit.

Pjesa e dyte fillon pa shume rritem dhe si per koinçidence ritmi ulet edhe me teper kur ne minuten 55 ambulanca del nga stadjumi per te derguar nje punonjes te stadjumit ne spital dhe arbitri ndal ndeshjen deri ne minuten 59 kur kthehet ambulanca.Vllaznia eshte disi me kerkuese per te arritur barazimin dhe ne minuten 73 Sosa shfrytezon nje gabim te portjerit Osmani dhe barazon rezultatin.Por gezimi i shkodraneve do te ndalej nga Cota ne minuten 91 qe i vetem ne zone shenon golin e fitores.Ne minutat shtese shkodranet barazuan por arbitri anulloi golin e tyre duke ngjallur protesta te shumta nga ana e kuqeblove.